



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2022:008549

Datë: 05.03.2024

Numri i dokumentit: 05414364

P.2022:008550

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA KAÇANIK, Gjyqtari Burim Çaka, procesmbajtësja Suzane Rudi, në çështjen penale kundër të pandehurit N.A, për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, sipas aktakuzës me numër PP/II.nr.66/22, të datës 17.01.202, të Prokurorisë Themelore Ferizaj, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik më datë 28.02.2024, në praninë e Prokurorit të Shtetit Ardian Emini, të pandehurit, përfaqësueses së palës së dëmtuar ...- T. K., mori dhe publikisht shpalli, ndërsa më datë 05.03.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri: N.A nga Komuna e Kaçanikut, Rr.“...” numër ..., i lindur më datë ..., nga i ati R... dhe e ëma Gj... e gjinisë M..., me numër personal ..., ka të kryer shkollës fillore, i martuar, prind i 2 fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së varfër ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës e Kosovës, i gjykuar edhe më parë.

ËSHTË FAJTOR

Sepse më datë 16.07.2021,29.10.2021 në Kaçanik rruga “Ramadan Agushi”, në vazhdim me anë të lajthimit siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla ashtu që me rastin e kontrollit nga

personat e autorizuar të ...-it, është hasur se i pandehuri dhe pse ka qenë i çkyçur nga distanca, ka bërë lidhje direkt në rrjetin elektrik dhe në këtë mënyrë është furnizuar me energji elektrike pa matje ,konkretisht energjia e shpenzuar nuk është regjistruar fare në njehsorin elektrik ... (grupi tarifar 4/02 shtëpiak) me ç ‘rast i shkaktuar kështu të dëmtuarës ...-it, dëme material në vlerë prej 587.75€.

- Me të cilat veprime ka kryer veprën penale Vjedhje e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së

Duke u bazuar në nenet 2, 17, 38, 39, 43, 46, 47, 48, 49, 69, 70, 71 dhe 72 të KPRK-së dhe nenit 358, 360, 364 dhe 452 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me:

DËNIM ME KUSHT

I. Dënim me burgim në kohëzgjatje prej 90 ditëve (Nëntëdhjetë ditëve), i cili dënim nuk do të ekzekutohet në qoftë se i pandehuri në afat prej 1 viti nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale.

II. Obligohet i pandehuri që palës së dëmtuar t’ia paguaj dëmin në vlerë 587.75€, në afat prej 15 ditësh pas plotfuqishmërisë së këtij Aktgjykimi.

III. I pandehuri lirohet prej shpenzimeve procedurale dhe të paushallit gjyqësor si dhe Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore Ferizaj ka ngritur aktakuzën me numër PP/II.nr.66/22, të datës 17.01.202 kundër të pandehurit të lartë cekur për shkak të veprës penale Vjedhje e shërbimeve

nga nenin 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 paragrafin 1 të KPRK-së dhe i ka propozuar gjykatës që të pandehurin ta shpall fajtorë dhe t'i shqiptohet sanksioni penal konform ligjit në fuqi.

Gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më datë 28.02.2024.

Në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, i pandehuri N.A e pranoi fajësinë për të gjitha pikat e aktakuzës, dhe gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se për shkak të kushteve të vështira ekonomike ka qenë i detyruar për të vepruar në kundërshtim me ligjin, i ka premtuar gjykatës që nuk do të përsëris të njëjtat veprime në të ardhmen.

Prokurori i Shtetit duke shprehur mendimin e tij lidhur me pranimin e fajësisë, mbështetet në provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe është konform nenit 248 të KPPRK-së. Dhe gjatë fjalës përfundimtare ka deklaruar se nga se nga provat materiale siç janë: procesverbali me Nr. 291464 i dt. 16.07.2023, procesverbali me nr. 2171594 i dt.29.10.2021, fatura e dt. 21.07.2021, fatura e datës 17.11.2021, raporti i kalkulimit i datës 21.07.2021, foto dokumentacioni dhe shkresat tjera që gjenden në lende ku pa mëdyshje u vërtetua se i akuzuari ditën kritike ka bere lidhje direkte në rrjetin elektrik dhe është furnizuar me energji elektrike pa matje dhe duke shkaktuar dëme të dëmtuarës ...-se. Andaj duke pasur parasysh të cekurat me lartë propozoj gjykatës që i akuzuari të shpallet fajtor dhe ti shqiptoj një sanksion penal të parapara nga KPRK-se, për veprën penale për të cilën akuzohet, me rastin e shqyrtimit të dënimit rrethana lehtësuese të merret pranimi i fajësisë, rrethana renduese nuk u gjetën.

Përfaqësuesja e palës së dëmtuar në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetin fjalën përfundimtare të Prokurorit të shtetit, i bashkë ngjitemi ndjekjes penale dhe paraqesim kërkesën pasurore juridike në vlerën e lartë cekur.

Pasi që i pandehuri ka pranuar fajësinë në fillim të shqyrtimit gjyqësor, gjykata për të vlerësuar pranimin e fajësisë e duke pasur parasysh edhe mendimin e Prokurorit të Shtetit, shqyrtoi me kujdes faktet e parapara nga neni 242 të KPPK-së dhe me këtë rast vlerësoi se: i pandehuri ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit; pranimi është bërë vullnetarisht;- pranimi i fajit mbështet në faktet dhe prova materiale të rastit konkret dhe atë me provat e paraqitura nga Prokurori i Shtetit të cilat gjenden në shkresat e lëndës, të gjitha këto prova të mbledhura gjatë procedurës hetimore; akuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Duke vlerësuar në aspektin e figurës së veprës penale gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit plotësohen të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale Vjedhje e shërbimeve në vazhdim nga neni 314 paragrafi 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së datë, vend dhe kohë siç është përshkruar në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të pandehurin, konform neneve 69, 70, të KPRK-së gjykata vlerësoi rrethanat lehtësuese dhe rënduese dhe gjeti si rrethanë posaçërisht lehtësuese se i pandehuri e ka pranuar fajësinë, rrethana lehtësuese pendimin e sinqertë dhe real për veprën penale të kryer dhe premtimin se nuk do të kryej në të ardhmen veprime të njëjta, i njëjti është i pa punë, është i gjendjes së varfër ekonomike, është mbajtës i vetëm i familjes 4 antarshe, ndërsa Gjykata nuk gjeti ndonjë rrethanë rënduese përpos veprimeve që plotësojnë figurën e veprës penale.

Sipas vlerësimit të Gjykatës dënimi i kushtëzuar i shqiptuar ndaj të pandehurit, duke i marr parasysh rrethanat e përmendura më lartë, minimumin dhe maksimumin e dënimit dhe gjendjes ekonomike të të pandehurit, është dënim i drejtë dhe me këtë dënim mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit nga neni 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tij, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehja e gjykimit shoqëror për veprën penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit

Vendimi për kërkesën pasurore juridike

Konform nenit 462 paragrafi 2 t KPPK-së, e obligoi të pandehurin për kompensimin e dëmit palës së dëmtuar të shkaktuar me veprën penale si dhe duke u bazuar në pranimin e fajësisë për të gjitha pikat e aktakuzës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Konform nenit 452 paragrafi 4 të KPP-së, të pandehurin e liroi nga shpenzimet e procedurës, paushallin gjyqësor si dhe Fondin për Kompensimin e Viktimave të Krimit, për arsyeje se pagesa e tyre do të rrezikonte gjendjen materiale të të pandehurit ose të personave që ai detyrohet t'i mbështesë materialisht.

Mbi bazën e të dhënave si më lartë, në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPPK-së, u vendos si n dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Dega në Kaçanik

P.2022:008550 datë 05.03.2024

Procesmbajtësja

Indira Beqa

Gjyqtari

Burim Çaka

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.